

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika Boom® S

SHKUMË E ZGJERUESHME POLIURETANI PËR FIKSIME, MBUSHJE DHE IZOLIME

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika Boom® S është shkumë poliuretani me tharje të shpejtë, e vetëzgjerueshme që aplikohet me tubetë për mbushje dhe izolime.

PËRDORIMET

- Izolim dhe mbushje e zgavrave
- Mbushje e fugave përreth kasave të dyerve dhe dritareve
- Izolim ndaj zhurmës, të ftohtit dhe hyrjes së rrymave të ajrit
- Mbushje përreth depërtimeve të kanaleve / tubacioneve / aspiratorëve
- Ngjitje të elementeve jostrukturorë të ndërtimit
- Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- 1 përbërës gati për përdorim
- Aplikim i lehtë me pipëz
- Shkallë e lartë zgjerimi
- Tharje e shpejtë
- Izolim termik shumë i mirë
- Amortizim akustik i efektshëm
- Pa HFC

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtuueshmëri me LEED v2009 IEQc 4.1: Materiale me çlirime të ulëta - Adezivë dhe izolues

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Shkumë poliuretani
Ambalazhi	tubeta 750 ml, me valvulë gome për presion 12 copë / kuti
Ngjyra	E verdhë e lehtë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5 °C dhe +25 °C. Të ruhen në pozicion vertikal. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe temperatura mbi +50 °C (rrezik shpërthimi). Kanaçet e hapura të Sika Boom® S duhet të përdoren brenda 4 javëve. Lexoni gjithmonë ambalazhin.

TË DHËNA TEKNIKE

Qëndrueshmëria e përmasave	± ~10 %
Temperatura e funksionimit	-30 °C min. / +80 °C max.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Rendimenti	750 ml	~32 l	(FEICA TM 1003)
Temperatura e produktit	Për rezultate më të mira, tubeta duhet të rrijë në temperaturë +20 °C.		
Temperatura e mjedisit	Optimale	+20 °C	
	E lejueshme	+10 °C min. / +30 °C max.	
Lagështia relative e ajrit	30 % min. / 95 % max.		
Temperatura e nënshtresës	Optimale	+20 °C	
	E lejueshme	+10 °C min. / +30 °C max.	
Koha e maturimit	Tharje e plotë pas 24 orësh		
Koha e prerjes	~25 min (pas kësaj kohe, mund të pritët një pjesë 20 mm)		(FEICA TM 1005)
Koha e tharjes së sipërfaqes	~10 min		(FEICA TM 1014)

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vaj, graso, pluhur dhe grimca të lira. Boja, korja e çimentos dhe materiale të tjera kontaminuese që pengojnë ndërkapjen duhet të hiqen. Sika Boom® S ngjitet pa prajmer dhe/ose aktivizues.

Lagni paraprakisht nënshtresën me ujë të pastër, kjo siguron se shkuma thahet sipas mënyrës së duhur dhe gjithashtu parandalon formimin dytësor të shkumës.

PËRZIERJA

Tundeni mirë kanaçen e Sika Boom® S të paktën 20 herë përpara përdorimit. Përsërisni pas ndërprerjeve të gjata të përdorimit.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Pas përzierjes, hiqni kapakun nga tubeta e Sika Boom® S dhe mbërtheni majën tek fileta e valvulës. Sasia e shkumës së nxjerrë mund të adaptohet duke ushtruar më pak ose më shumë presion tek këmbëza.

Mbushni fugat e thella (> 50 mm) me disa shtresa. Lejoni që secila shtresë të zgjerohet dhe forcohet mjaftueshëm përpara se ta lagni me ujë sërish për aplikimin e shtresës vijuese.

Mbushini vetëm pjesërisht hapësirat / zgavrat, pasi shkuma zgjerohet gjatë tharjes.

Hapësirat e vogla mund të mbushen me një tub zgjatimi, megjithatë kjo gje do të reduktojë shpejtësinë e rrjedhjes së shkumës.

Kur përdoret për ngjitjen e përbërësve vertikal / horizontal të ndërtimit, këto duhet të fiksohen përkohësisht derisa shkuma të jetë tharë plotësisht.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni menjëherë pas përdorimit të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Sika Boom® Cleaner ose Sika® Remover-208. Pas tharjes, materiali i mbetur mund të

hiqet vetëm mekanikisht. Për pastrimin e lëkurës përdorni Sika® Cleaning Wipes-100.

KUFIZIME

- Për rezultate të shkëlqyera, kanaçja duhet të ketë qëndruar në ambient me temperaturë +20 °C.
- Për cilësi të mirë të shkumës, temperatura e kanaçes nuk duhet të jetë më tepër se +10 °C nga temperatura e ambientit.
- Mos mbushni plotësisht hapësirat me material të lagësht, pasi shkuma zgjerohet gjatë tharjes.
- Për tharjen e saktë të shkumës nevojitet lagështi.
- Lagështia e pamjaftueshme mund të çojë në zgjerim të mëvonshëm të paqëllimshëm të shkumës.
- Të mos përdoret për qëllime fiksimit mekanik ose strukturor.
- Mos e përdorni mbi polietilen (PE), polipropilen (PP), politetrafluoroetilen (PTFE / Teflon), silikon, vaj, graso dhe agjentë të tjerë disarmimi.
- Nuk ka rezistencë ndaj rrezeve UV.

Fleta e të dhënave të produktit

Sika Boom® S

Dhjetor 2019, Botimi 03.01

02051406000000010

BUILDING TRUST



BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika Boom® S

Dhjetor 2019, Botimi 03.01
02051406000000010

SikaBoomS-sq-AL-(12-2019)-3-1.pdf